



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V-të

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 4.

Prishtinë, më 29.12.2014 në ora 11:40.

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqiu, Xhavit Haliti, Vjosa Osmani, Luljeta Veselaj- Gutaj
Rrustem Mustafa, Ilir Deda dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Blerim Shala, Arben Gashi, Valdete Bajrami dhe Slllobodan Petroviç.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqia – kryetare e Komisionit.

Rendi i Ditës

- 1. Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 me amendamentet e Komisionit funksional për buxhet dhe financa**

Pas ndërprerjes së seancës plenare për shqyrtimin e amendamenteve nga komisionet e përhershme Kryetarja kërkoj që pasi kishte kuorum të shqyrtohet raporti me amendamente dhe nëse ndërkohë vjen ndonjë amendament tjetër plotësues ,mbledhjet komisioni prapë gjatë ditës dhe do të jetë ma lehtë pastaj dhe hapi debatin.

Ilir Deda: tha se pas mbledhjes së komisionit i kishte analizuar amendamentet dhe kishte vlerësuar se nuk kishte asgjë diskutabile përveç racionalizimit të shpenzimeve,pra amendamentet e propozuara nga komisioni funksional nuk janë në kundërshtim me acquis comunitare ,prandaj mund ta plotësojmë raportin.Ne mund të takohemi edhe një herë dhe ta vazhdojmë mbledhjen nëse ka amendamente plotësuese pas drekës.

Vjosa Osmani: u pajtua të dalim me rekomandim se raporti me amendamente nuk është në kundërshtim me acquis comunitare.

Kryetarja: pas diskutimeve konstatoj që si komision të dalim me rekomandime tani ,sepse edhe nëse ka amendamente shtesë prapë të takohemi pas dreke në orën 13:30min,por ato nuk

mund të ndikojnë në substancën e vërejtjeve tona, sepse nuk mund ta sigurojnë as pavarësinë buxhetore dhe të gjitha ato çka kemi kërkuar

Pas diskutimeve lidhur me amendamentet e Komisionit funksional për buxhet dhe financa Kryetarja konstaton se Komisioni një zëri nxori këtë;

R e k o m a n d i m

1. Projektligjin nr. 05-L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, nuk është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të Bashkimit Evropian.
2. Amendamentet të propozuara nga komisioni funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin primar dhe sekondar të BE-së, përkatësisht me Acquis të BE-së.
3. Në Projektligjin nr. 05-L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 nuk është paraparë pavarësia buxhetore e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kërkesë e Raportit të Progresit dhe Plani i Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.
4. Buxheti i ndarë për vitin 2015 për Ministrinë e Integrimit Evropian krahasuar me projeksionin e viteve 2016 dhe 2017 është më i madh, prandaj do të duhej të kishte një sqarim nga Ministria e Integrimit Evropian për projeksionet apo vlerësimet për vitin 2016 dhe 2017. Po ashtu, kjo Ministri nuk ka paraparë asnjë projekt për vitin 2015.
5. Mungesa e pjesës narrative apo përshkruese e shifrave tabelore e bënë mjaft të vështirë analizimin e Projektligjit për Buxhetin, prandaj në të ardhmen do të duhej të përcillej me narrativ- përshkrim.
6. Shqetësuese mbetet edhe mungesa e ndarjes së mjeteve financiare në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, për arritjen e objektivave të parapara në Planin e Veprimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Pasi në ndërkohë komisioni për buxhet dhe financa kishte nxjerr raport plotësues Komisioni vazhdoi mbledhjen në orën 13;30 ashtu si ishin marr vesh.

Kryetarja: kërkoj të shqyrtohet raporti plotësues i amendamenteve të sjellura nga komisioni për buxhet dhe financa.

Pas shqyrtimit anëtarët prezent konstatuan se raporti me amendamente plotësuese nuk bie ndesh me direktivat e BE-së.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Znj. Teuta Sahatqia
